

Cilët janë faktorët kyç të suksesit për hartimin e një programi efektiv trajnimi për menaxhimin e financave publike (MFP)?
Diskutim Inteligjent Interaktiv i Programit PULSAR



Ngritje e zotësive. Kapërcim i kufijve.

Një kuadër i gjithanshëm i reformave merr në konsideratë ngritjen e kapaciteteve organizative



Burimi: Banka Botërore / Universiteti i Shkencave të Aplikuara i Zyrihut (2018). *Model i praktikës së mirë për një dokument udhërrëfyese të reformave të kontabilitetit në sektorin publik.*

Një qasje e çekuilibruar për reformat me fokus të ulët në masat e ngritjes së kapaciteteve


Objektivat + Strategjia / qasje + Trajnimi dhe kapacitetet + Kultura = Iluzion

Objektivat + **Strategjia / qasje** + Trajnimi dhe kapacitetet + Kultura = Pështjellim

Objektivat + Strategjia / qasje + **Trajnimi dhe kapacitetet** + Kultura = **Ankth**

Objektivat + Strategjia / qasje + Trajnimi dhe kapacitetet + **Kultura** = Acarim

Grupet funksionale dhe programet individuale të lëndëve: Pikënisje e mundshme



Një program i qëndrueshëm trajnimi merr në konsideratë çështjet e mëposhtme.



Caktohet kush e ka në zotërim projektin në funksion të ngritjes së kapaciteteve

Projektit duhet t'i dalë zot njësia e MFP-së e ngritur për reformën e MFP-së, për shembull njësia e metodikës kontabël e cila mundëson bashkërendimin e duhur të realizimit të trajnimit me aktivitete të planifikuara e të bashkërenduara me njësitë e burimeve njerëzore.



Zhvillohen dhe përdoren njohuritë e brendshme teknike

Duhet gjetur një kombinim i balancuar midis trajnimeve të jashtme të certifikuara dhe mekanizmave të brendshme të ngritjes së kapaciteteve si qasja “trajnim i trajnuesve”.



Trajnimi bëhet afër përdorimit

Boshllëqe të mëdha kohore midis trajnimit dhe zbatimi bëjnë që njerëzit të harrojnë. Sigurisht, përdorimi varet nga funksioni/roli.




Ofrohet trajnim i përsëritur

Psikologjia pedagogjike tregon se përsëritja i fikson dijet. Gjithashtu, qarkullimi i personelit kërkon trajnim të vazhdueshëm.

I brendshëm apo i jashtëm?

 **Caktohet kush e ka në zotërim projektin në funksion të ngritjes së kapaciteteve**

 **Zhvillohen dhe përdoren njohuritë e brendshme teknike**

Përqëndrimi duhet të jetë në njohuritë e brendshme teknike:

- Zhvillohen njohuritë e brendshme teknike: Trajnim profesional ndërkombëtar (për kontabilitetin në sektorin publik p.sh. ACCA, CIPFA, ICAEW, ..) për një bërthamë
- Përhapen njohuritë teknike të bërthamës: Përgatitja e materialit të trajnimit sipas juridiksionit, “trajnim i trajnuesve”
- Përdoren njohuritë e brendshme teknike: Trajnimi në nivel operativ mund të bëhet vetëm brendapërbrenda
- Ruhen njohuritë e brendshme teknike: U ofrohet perspektivë në vendin e punës, sidomos atyre që kanë marrë pjesë në trajnimin profesional ndërkombëtar


Lakorja e Ebbinghaus-it për harrimin dhe mësimin



Trajnimi bëhet afër përdorimit



Ofrohet trajnim i përsëritur



Burimi: medium.com

- Duhet ulur lakorja e harrimit
 - Përdorim sa më shpejt = përsëritje me praktikë
 - Trajnim i përsëritur, në veçanti për dijet më pak të përdorura, p.sh., veprimet e mbylljes së vitit
- Trajnimi i përsëritur nevojitet edhe për personelin e sapomarrë në punë

Faleminderit për vëmendjen.